

BERISHA E PUKËS
ZANAFILLË PARAROMAKE DHE VATËR E PRINCIPATËS SË DUKAGJINËVE
Kol DEDAJ

Studiues, Akademia "Rrënjët Tona"

PËRMBLEDHJE

Rrethi i Pukës shtrihet në veri-lindje të Shqipërisë. Me ndarjen administrative e territoriale të vitit 2014 ka dy bashki, Pukë dhe Fushë-Arrëz. Qendër e rrethit / nëprefekturës është Puka. Në periudhën e pushtimit romak, territoret shqiptare qenë ndarë në dy provinca të mëdha *Iliriku* dhe *Epiri*. Me zhbërjen e fiseve ilire, në përgjithësi fiset shqiptare filluan lëvizjet migratore, ku të sapo ardhurit e gjenin vendin pjesërisht të banuar me popullsi vendase dhe më rrallë plotësisht të pabanuar dhe në varësi të supermacisë së etnive vendoseshin edhe rregullat e organizimit shoqëror. Por, sikurse shpjegon *Giussepe Valentini*¹ kemi një shembull që e gjeti "*vendin të pabanuar*" dhe kjo është Berisha malet e së cilës *Franc Nopça*² i quante "Malet e Berishës". Në Dukagjin vetëm Berisha është fis monofiletikë ndërsa të gjitha fiset e tjera janë polifiletikë³.

Fjalë kyçe: zanafillë, principatë, e vjetër, provincë, fis.

ABSTRACT


Puka district lies in the north-east of Albania. With the administrative and territorial division of 2014, there are two municipalities, Puka and Fushë-Arrëz. The center of the district / sub-prefecture is Puka. In the period of Roman occupation, Albanian territories were divided into two large provinces Illyricum and Epirus. With the dissolution of the Illyrian tribes, in general, the Albanian tribes started migratory movements, where the newcomers found the place partially inhabited by locals and rarely completely uninhabited and depending on the supremacy of ethnicities, the rules of social organization were established. But, as *Giussepe Valentini* explains, we have an example that found the "uninhabited place" and this is Berisha whose mountains *Franc Nopça* called the "Berisha Mountains". In Dukagjini only Berisha is a monophyletic tribe while all other tribes are polyphyletic.

Key words: genesis, principality, old, province, tribe.

HYRJE

*Franc Nopça*⁴ shpjegon se emrin Mirditë e takojmë për herë të parë në vitin 1416, por pastaj zhduket deri në 1610 dhe në 1690 bëhet i njohur përgjithësisht, ndërsa Dukagjinin dhe Mirditën i quan "Malësi Qëndrore"⁵. *Robert Elise* në veprën e tij "Fiset Shqiptare" shpjegon se termin Mal zi (Spas) e hasim për herë të parë në vitin 1444. *Giussepe Valentini*⁶ migrimin e Thaç-it e tregon nga Tuzi në Malin e Zi, në Bushat të Shkodrës, duke i dhënë jetë fillimit të Dinastisë së Bushatlinjëve, në Gojan të Epërm në Pukë, në kodër Gegë dhe më vonë në 1640-1670 drejt Iballës, ku gjeti fisin e Berishës, e cila e popullonte atë zonë. Ndërkohë që *Rrok Zojzi*⁷ në studimin e tij tregon se fisi i Thaç-it kapërceu Drinin dhe u vendos pranë Iballës, mirëpo nuk arriti ta bënte këtë vend pjesë të masëlisë, por u bë vetë pjesë e Dukagjinit. Arkeologu i njohur Prof. Dr. *Karl Patsch*⁸ në librin e tij "Ilirika" shprehimisht thotë se "*Beriscus-Berishë*" është emër i moçëm, me të cilin quheshin Alpet e Shqipërisë. *Strabioni*, në veprën e tij të njohur *Geographica*, në librin e VII, shpjegon se ky emër përkon me zonën ku janë Alpet e Shqipërisë. Berisha në antikitet në shekullin I të "Erës së Re" njihej me emrin *Bertiscus- Bertish*, nga *Apiani*, emër i cili kishte kuptimin gjithëpërfshirës të Alpeve e më vonë për një zonë me popullsi të caktuar me emrin etnologjik⁹. Gjurmët e fisit Berishë na kthejnë prapa në histori, para periudhës romake¹⁰. Prof. Dr. *Shevqet Sahit Canhasi*¹¹, shpjegon se në vitin 1332-1334, sllavet arritën në Pukë, ku banonte fisi Berishë. *Giussepe*

Valentini¹², shpjegon se në vitin 1242 dhe 1270 hasim "Berissa comitis" (Konti i Berishës) të cilin mund ta konsiderojmë si patronimat, ndonëse në dokumentat e Vatikanit¹³ haset së paku që nga vitit 1216, ndërsa sipas Han¹⁴, në vitin 1274, hasim kapedan Tanusis Bessossia (Tanush Berisha) hartues i notës së protestes ndaj Bizantit. Nopça bënë lidhjen e Lekë Dukagjinit me Tanush Berishen¹⁵ nga "familja e lashtë e Berishajve", që sipas Th. Ippen¹⁶ mbante titullin zot i Zadrimës, Malzi-ut, Pulatit, Shatit, ndërsa në mesjetë Lezha (Alessio) i përkiste për ca kohë familjes së Dukagjinëve, e cila në vitin 1393 ia lëshoj atë Venedikut. Barleti¹⁷, shpjegon se nga "familja e lashtë Berishajve" qenë dy nga komandantët kryesor të Gjergj Kastriotit-Skendërbeu, Dhimitër dhe Nikoll Berisha me kontribut të madhë në betejën e vitit 1456 kundër Osmanëve. Oliver Schmitt¹⁸, shpjegon se Berisha ka qenë një fis i madh jo vetëm si territor, por edhe si popullsi, në vitin 1465 ajo kishte 12 mijë banorë, një shifër tepër e madhe kjo, për kohën kur bëhet fjalë. Albanologu Rrok Zoijsi¹⁹ sqaron se emri Dukagjin është shumë i përhapur dhe ka gjasa të rrjedhë nga Duka i mesjetës Gjini Tanushi "Ducam Ginium Tanischum" i vitit 1281, por në një kuptim shumë të gjërë krahinor ngelet në trevën e Pukës.



Në shekullin e XII, krejt zona ku shfaqet rruga e madhe Shkodër-Pukë-Prizren është zona ku shfaqet "Principata e Dukagjinëve" kurse në jug të saj shtrihej Arbina që kishte të veten edhe Oroshin dhe Fanin. Kufiri midis principatës së Dukagjinëve dhe të Arbinës ishin malet e Pukës dhe Mirditës. Populli i Dukagjinit paraqitet si trashëgimtar i principatës mesjetare të Dukagjinëve. Gjatë pushtimit turk kemi migrim të popullatës së Dukagjinit, ku një pjesë u zhvendosen në veri të Drinit dhe një pjesë në drejtim të jugut në vendin e Mirditës, Lezhës, etj. Nga këto lëvizje disa i ruajtën traditat, ndërsa grupimet e tjera u shkëputen si "Dukagjin i Ri" duke ndryshuar disa nga doket, zakonet, etj. Më tej, Zoijsi *Dukagjinin ose Leknin* i pasqyron edhe me hartë duke e njësuar me Pukën e sotme, e cila jepet në Fig. 1: Dr. Milan Shufflay²⁰ shpjegon se kur anzhuitët erdhën në Durrës në vitin 1277, ata gjetën shtresën e dytë të fiseve që prej kohës ilire ishin krijuar në këtë trull me familje të fuqishme aristokratike me të cilat bënë marrëveshje me të parët e tyre (1272-1274 Skurajt, Letët, Missiajt, Arianitët, Bessossia-jt-Berisha-jt), por dhe me fisnikërinë e kalorësisë (1274 Vlado Blinishti, Theopia miles). Këtë aristokraci azhurnët e thërrasin comits ose Kont, Princa, Kapedan në rajonin e Shqipërisë. Familjes Dukagjini i solli *eponimin* e titullit "Dukë", Gjini Tanushi (1281 Ducam Ginium Tanuschum Albanenesm). Shumë interesante paraqitet përcaktimi, vlerësimi dhe ndarja që Shufflay bën mes aristokracisë së fiseve dhe fisnikëve të kalorësisë së kohës. Në mënyrë të përmbledhur zanafilla e kësaj dinastije jepet në vijim.

Ducam-Ginum-"Tanuschum I"-Bessossia-Albanenesm=Duka-Gjin-"Tanushi I"-Berisha-Shqiptari.



Th. Ippen²¹, thekson se terreni malor në jug të Drinit (Berisha) ishte vendndodhja e familjes së rëndësishme të Dukagjinëve, i cili edhe sot mban emrin Dukagjin. Puka, është qendra administrative për krahinën e Dukagjinit. Emri i kësaj krahine rrjedh prej dinastisë së familjes shqiptare Dukagjin. Anëtari më i lashtë i kësaj familje është **Tanush Dukagjini (Tanush Berisha, Tanushi I)**, zot i Zadrimës, Malzi-ut, Pulatit, Shatit, zotërues i Fanit dhe Fletit ku dhe ngriti një kështjellë. Ippen, zonën e vargmalit jugor të lumit Drin e quan si "Malësia e Drinit apo Dukagjinit" për faktin se aty është vendndodhja e familjes së rëndësishme të dukagjinëve dhe së dyti për faktin se këto vargmale në rrjedhën e majtë në jug të Drinit shoqërohen nga ky lumë. Para pushtimit turk malet shqiptare qenë gjithmonë të pavarura, ato kishin në gjirin e tyre një numër të madh zotërimesh dhe prej tyre vareshin të gjitha fshatrat. Malet e

Berishës vareshin nga familja e famshme e Dukagjinëve, vet Lek Dukagjini, këtu kishte shtëpinë, kullën ku dhe kishte zhvilluar një betejë me rivalët e tij²². Por, sipas dokumentave të Akademisë së Studimeve Albanologjike²³, Lek Dukagjini e kishte kullën e tij me gur të gdhendur e të lidhur me gëlqere në lagjen Pap të Berishës, afër kishës së Shën Gjergjit dëri në vitet 1930, kohë në të cilën u shkatërrua për të marrë e përdorur të gatshëm gurët e saj të gdhendur. Në 1387 vëllezërit Pal dhe Lek Dukagjini, që banonin përgjatë rrugës tregtare nga Shkodra për në Prizren u lejuan njerëzve nga Raguzat të kalonin përmes tokave të tyre²⁴.




Fig.3:N.Lako, hartë vitit 1913(Dukagjin=Berishë,Thaç,Malzi)

Familja Dukagjini²⁵, zotëronte krahinën që shtrihej prej bregut të Adriatikut në Lezhë në të dy brigjet e lumit Drin në drejtim të Prizrenit dhe Gjakovës. Ndërsa shtrirja e sotme e Dukagjinit është mjaft e vogël, ai kufizohet në bregun e majtë të Drinit dhe emërtohet si kazaja e Pukës ku përfshin "7-Bajrakët e Dukagjinit".

Robert Elsie²⁶ shpjegon se Merturi është një fis me Berishën, për të cilët thuhet se ka prejardhjen Lek Dukagjini, ai u shkëput në vitin 1520. Merturi është Berishë dhe rrjedhë nga familja princërore e Dukagjinit²⁷. Në pemën gjeneologjike të familjes Dukagjini jepet: "Lesch II", prijës i Burischan, Bengaret dhe Bolchia në vitin 1407, por Jules Alexandre Théodore²⁸ na thotë se është prijësi i Berishës së sotme. Po ashtu, Ippen²⁹, Burishanin e njeh si fisi i sotëm i Berishës. Oliver Jens Schmitt³⁰, shpjegon se në shkurt të vitit 1467, Fisi i Berishës nënshkroi marrëveshje me Venedikun. Fisit iu dha e drejta e mbajtjes së flamurit të "Shën Markut" dhe prijësit të fisit iu dhurua një kostum i quajtur "Pellanda" që përdorej nga princat e kohës. Ndërsa sipas dokumentave të Akademisë së Shkencave të R.P.SH, Instituti i historisë³¹, përfaqësuesit të fisit në këtë marrëveshje Helias Bossi iu dhurua një "Mantel Kadifje" e kuqe sipas zakonit. Gjithashtu, në dokumentat e *Akademisë së Shkencave të R.P.SSH, Studime Filologjike*³², Tebrunen Kahrema Ulqini e vendos në Berishë, por Kol Luka e mendon në Pult e jo në "*Dukagjinin Historik*" (*Berishë*). Pra, *Berisha* dhe "*Dukagjini Historik*" janë i njëti vend, gjë e cila pasqyrohet nga shumë autor, dokumenta e harta njëra prej të cilave gjendet në fig. 3, harta e vitit 1913, nga N.Lako, ku jepet Malzi-u, Thaçi dhe Dukagjini i njëjtë me Berishën në jug të lumit Drin në rrjedhën e majtë të tij. Po ashtu, Robert Elsie³³, shpjegon se "Dukagjini i Vjetër" gjendet në malet e Pukës në jug të lumit Drin në anën e majtë të rrjedhës së tij. Në foto nr.4 jepet lumi Drin dhe vargmali i Kashit në rrjedhën e majtë në jug të lumit Drin, lagjja Brebulla e Berishës. Ermanno Armao³⁴, thotë se "*Popujt e Iballës*", janë pjesë e fisit të madh të Dukagjinëve në të cilët përfshihen Berisha, Iballa, Bugjoni nga mali i Krrabit deri tek lumi Drin. Tek Etnogarfia shqiptare³⁵, thuhet se Vendet e Dukagjinëve, Iballë, Spas (Mal Zi), Pukë, nuk janë nën zgjedhën e turqve për shkak të pozitave të forta të atyre vendeve.



Fig.4: Brebulla, Berishë. Rrjedha e majtë e Lumit Drin në jug të tij dhe Varg mali i Kashit, Foto: Kol Dedaj, 2018

Një shpjegim i zgjeruar jepet nga dokumentat Britanike³⁶, mbi kuptimin e termave, Dukagjin dhe "Rrajoni i Dukagjinit":

- 1- Në kuptimin më të saktë, termi Dukagjin, përdoret për të treguar një rajon të përbërë prej tre bajraqesh: atë të origjinës Berishën, si dhe dy bajrakët e Thaçit (Iballën dhe Bugjonin). *Dukagjinasit, qenë një familje prijësish. Leka, është një hero, autori i Kanunit të madh, e bashkëkohës me Skendërbeun.*
 - 2- Në një kuptim tjetër termi "Dukagjin"-13, përdoret për të treguar "7-Bajrakët e Dukagjinit", domethenë: 2-Berishë, 6-Bugjon, 25-Iballë, 26-Kabash, 41-Malzi, 54-Pukë, 56-Qerret, të cilët jepen në hartën Britanike Fig.5, Shqipëria 1945.
 - 3- Në kuptimin rajonal termi "Rajoni i Dukagjinit" përdoret për të treguar gjithë hapësirën midis "Drinit dhe Mirditës që banohet prej fiseve: të Dukagjin-it (Berishës), të Kabashit, të Thaçit dhe të Malziut. Ata zenë, vargmalin e lartë në "Jug të Drinit" në të majtë të rrjedhës së tij. Në vitin 1901 turqit, qendër të "Rajonit të Dukagjinit" caktuan Pukën.
 - 4- Në kuptimin e përgjithshëm, termi "Dukagjin" përdoret për të treguar, Pultin, Shoshin, Dushmanin, Toplanën, Nikajn e Merturin të quajtur Fiset e "6-Bajrakëve".
- Por, Shala e Shoshi e quajnë veten "Dukagjinas" në vendin ku banojnë aktualisht, nga që ata janë të ardhur nga "Rajoni i Dukagjinit", që ndodhet në jug të lumit Drin. Të shumta janë toponimet që kanë lidhje me Lek Dukagjinin, që mbartin emrin e tij të cilat gjërësisht janë trajtuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike. Por, emri Dukë, Duka, Dukate, Dukat, etj. (Duka-Gjin=Dukagjineve) është i përjetësuar dhe përhapur në Shqipëri nga jug në veri në trajtën e mbiemrave, toponimeve, etj. Por, në rrethin e Pukës, ai në vazhdimësi gjendet edhe në trajtën e emrit të njerëzve si tek meshkujt dhe tek

femrat, Dukagjin Sokoli në Bugjon, Pjetër Duka, Agustin Duka në Iballë, Dukate Nikolla (1919-2017) në Iballë, kunata e artistit të mirënjohur Tom Nikolla, Dukate Stak Deda në Berishë në lagjen Belshinë tek kulla historike e Ndoc Mark Dedës (Dëshmor i Atdheut), kullë e cila gjendet në rrëzë të shpatit të malit të Kashit dhe në jug të lumit Drin në të majtë të rrjedhës së tij.

Nga, ballafaqimi, krahasimi, analiza dhe sinteza e dokumentave shkresore, hartografike e gjeografike arrijmë në disa konkluzione:

- 1-Familja aristokratike e Berishajve (Bessossia-jt) është zanafillë e familjes së Dukagjinëve;
- 2-Tanush Berisha Shqiptari (Tanushi I), është i pari i familjes së lashtë të Dukagjinëve;




Fig.5:Hartë, Shqipëria 1945, fiset e veriut

- 3- Zanafillë e Dukagjinit, Dukagjinit të vjetër, Dukagjinit Historik dhe Dinsatisë së Dukagjinëve është në jug të lumit Drin në anën e majtë të rrjedhës së tij në Berishë të rrethit Pukë;
- 4- Sipas dokumentave shkresore e hartografike Berisha e Pukës njësohet si zanafillë me Dukagjinin, Dukagjinin e Vjetër,Dukagjinin Historik, etj.
- 5- Dinastia e Dukagjinëve ka shtrirje nga Fani në Drin në të dy anët e tij ne drejtim të Prizrenit e Gjakovës, dhe nga Kosova në Adriatik. Shtrirje kjo ndër më të mëdhatë në principatat Shqiptare;

- 6- Dinastia e Dukagjinëve i ka fillesat së paku në shekullin e XIII e deri në krijimin e shtetit Shqiptar. Me një shtrirje kohore mbi 600 vjeçare, më e madhja e njohur në historinë e Shqipërisë;
- 7- Me rënjen e dinastisë së Dukagjinëve viset e Pukës u quajtën "Dukagjin i Vjetër" si dhe u krijuan krahina të reja të quajtura "Dukagjini i Ri" apo emërtime të tjera.

PËRFUNDIME

Në pamundësi që përmes këtij punimi, të paraqiten shumë dokumenta për këtë *"Plejadë Dinastie të Principatës së Dukagjinëve"*, e cila qëndron në embrion të Kombit Shqiptar, ato do të jenë pjesë e punimeve monografike dhe hartografike në të ardhmen.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Giuseppe Valentini, "E drejta e komuniteteve në traditën juridike Shqiptare", Plejad 2007, f.25,227-243;
2. Franc Nopça, Fiset e Malësisë së Shqipërisë veriore dhe e drejta zakonore e tyre, 224;
3. Po aty, f.273.
4. Po aty, f.232;
5. Po aty, f.274;
6. Giuseppe Valentini, "E drejta e komuniteteve në traditën juridike Shqiptare", Plejad 2007, f.230;
7. Rrok Zojzi, Ndarja krahinore e popullit Shqiptar, f.37;
8. Prof.Dr.Karl Patsch, "ilirika" Tiranë 1926, f.6;
9. Avdyl Hoxha & Rexhep Maksutaj, "12- Fiset Shqiptare sipas Kanunit të Lek Dukagjinit"; 10.Carleton S. Coon, "The Mountains of Giants,, Cambridge, Massachusetts, USA, 1950, f.45; 11.Prof. Dr. Shevqet Sahit Canhasi, Fllakadani i lirisë, Bajram Daklani, Treleborg-Suedi, 2017, f.37;
12. Giuseppe Valentini, E drejta e komuniteteve në traditën juridike Shqiptare, plejad alanollogjike, f.268,426;
13. Shqipëria, Gusht 1945, Tiranë 2020, f.213;
14. Han, Reise Drin Wardar 278, Hopf I,300, nr77;
15. Ibrahim Kadri Malaj, Tropoja ne vite, f.393;
16. Th. Ippen, Shqipëria në fokusin e perandorisë Austrohungareze, f.157,173;
17. Marin Barleti, historia e Skendërbeut, f.445;
18. Oliver Schmitt, "Arbëria Venedike", Tiranë 2007, f.496;
19. Rrok Zojzi, Gegnia, f11-12;
20. Dr. Milan Shufflay, Historia e shqiptarëve të veriut, F25-27;
21. Th. Ippen, Malësia e Drinit apo Dukagjinit, f62-63, 180, 182,183,f.200;
22. Giuseppe Valentini, "E drejta e komuniteteve në traditën juridike shqiptare", Plejad 2007, f.137; 23. Akademia e Studimeve Albanologjike, Studime Mesjetare në Toponomastik dhe Onomastikë, Tiranë 2019, f.531-532;
24. Shqipëria, Gusht 1945, Tiranë 2020, f.213;
25. Th. Ippen, Malësia e Drinit apo Dukagjinit, f62-63;
26. Robert Elsie, Fiset Shqiptare, f.179,328;
27. Ibrahim Kadri Malaj, Tropoja ne vite, f.394;
28. Souvenirs de la Haute-Albanie, Degrand, Jules Alexandre Théodore, Paris,: H. Welter, 1901. fq 315;
29. Th. Ippen, Malësia e Drinit apo Dukagjinit, f62-63 ;

30. Oliver Jens Schmitt-Arbëria Venediek 1392-1479, f.461-464;
31. Akademia e Shkencave të RPSH, Instituti i Historisë, Sektori i Etnografisë , Etnografia Shqiptare VII, Andromaqi Gjergji, Vështrim historik mbi veshjet në Shqipëri, Tiranë 1976, f.90;
32. Studime Filologjike, Akademia e Shkencave të RPSSH, Instituti i Gjuhës dhe Letërsisë ,f.146;
33. Robert Elsie,Fiset Shqiptare, f.328;
34. Ermanno Armao, lokalita, chiese, fiumi,monti e toponimi di un'antica carta dell'Albania Settentrionale, Rome, f.177;
35. Kol Luka,Etnografia shqiptare, f.58;
36. Personnages Albanie, Londër 1916, Personazhet kryesore të Shqipërisë, f.164-165.